



Republika e Kosovës  
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

REPUBLIKË E KOSOVËS \* REPUBLIKA KOSOVA  
KOSOVA CUMHURIYETİ  
Komuna e Prizrenit - Opština Prizren  
Prizren Belediyesi  
Kryetari i Komunes Predsednik Opštine  
Belediye Baškanı

01 Nr. 303/25 Dt. 15.05.2025



Komuna e Prizrenit  
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

## Procesverbali për Projekt-Rregulloren për Varrim dhe Mirëmbajtjen e Varrezave të Reja të Prizrenit në Landovicë

**Publikimet:**

Publikimet janë bërë me **05.05.2025** në webfaqe zyrtare të komunës, në facebook-un e komunës, si dhe në platformën e konsultimeve publike:

Në webfaqe:

<https://prizren.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/05/Njoftim-per-organizimin-e-KONSULTIMIT-publik-per-Projekt-Rregulloren-Varrim-dhe-Mirembajtjen-e-Varrezave-te-Reja-te-Prizrenit-ne-Landovice.pdf>

Në platformë:

<https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=42820>

Njoftimi si lajm në webfaqe:

<https://prizren.rks-gov.net/news/njoftim-per-organizimin-e-konsultimit-publik-per-projekt-rregulloren-varrim-dhe-mirembajtjen-e-varrezave-te-reja-te-prizrenit-ne-landovice/>

Njoftimi në Facebook:

<https://www.facebook.com/share/p/1DxZL2j112/>

**Me 05.05.2025**, njoftimi dhe projekt-rregullorja (në tri gjuhë) u është dërguar përmes emailit, qytetarëve, klubet sportive, OJQ, organizata të ndryshme, drejtore të shkollave, bizneseve, organizatat studentore, ekspert të fushave, mediat lokale, shoqatave të ndryshme si dhe organizata rimore, që të kenë mundësi të njihen më detajshëm me dokumentin në fjalë, sepse disa nga ta nuk kishin pasur mundësi ta lexonin të publikuar në ueb faqe.

**Me 14.05.2025**, është mbajtur konsultimi publik, vegëza e publikimit të lajmit për mbajtjen e konsultimit:

Në webfaqe:

<https://prizren.rks-gov.net/news/u-mbajt-konsultim-publik-per-projekt-rregullores-per-varrim-dhe-mirembajtjen-e-varrezave-te-reja-te-prizrenit-ne-landovice/>

## Konsultimi ka filluar në orën 11:15

**Ymer Berisha-Udhëheqës i Njësisë për Komunikim me Publikun ka hapur konsultimin publik duke falënderuar qytetarët, përfaqësues të shoqërisë civile, të nderuar gazetarë, media në përgjithësi, në emër të kryetarit të komunës zoti Shaqir Totaj, përshëndes të gjithë veçanërisht të gjithëve së bashku dhe po vazhdojmë si komunë që të shkruajmë dokumente profesionale dhe që janë në funksion të kauzave për të cilat shkruhen.**

Njoftoj audiencën dhe të gjithë qytetarët e komunës së Prizrenit se po bëjmë draftë rregullore për varrim dhe mirëmbajtjen e varrezave të reja të komunës së Prizrenit.

Ky dokument prek secilën familje, madje ky dokument rregullon edhe secilin individ për arsy se krejt qeniet njerëzore të gjalla, i nënshtrohen procesit të vdekjes dhe ne dëshirojmë që edhe ky proces të rregullohet profesionalisht me kujdes maksimal, me kujdes të ekspertëve dhe të njerëzve të cilët kanë ndjeshmëri të kësaj fushe.

Dokumenti është bërë publik dhe sigurisht ju keni edhe kopjet fizike, tashmë në mbajtje. Po ashtu komuna e Prizrenit është kujdes se ky dokument që publikohet në webfaqen zyrtare të komunës së Prizrenit dhe në platformat e rrjeteve sociale që komuna ka.

Qëllimi është që tërë dokumentin kanë mundësi ta shohin të gjithë qytetarët, të gjithë grupet shoqërore, të gjithë ata të cilët janë të interesuar të jepin komente, ide, sugjerime ose gjetje, në mënyrë që ky dokument të jetë sa më përmbrasor dhe sa më gjithëpërfshirës. Komuna është duke implementuar politikat e hapura, qytetarin dhe kërkosat e tij i ka në fokusin kryesor.

Ymer Berisha-Kështu që bartës i këtij dokumenti dhe i kësaj politike publike është drejtoria e shërbimeve publike, këtu e kemi edhe zotin Çelë Lamaj drejtor i DSHP-së dhe zyrtarin Perparim Shala nga DSHP-së, të cilët me kujdesin maksimal do të marrin të gjitha sugjerimet e tuaja dhe ato të cilat mund të inkorporohen në këtë dokument, do të kemi kënaqësinë që t'i inkorporojmë me të vetmin qëllim për të gjithë qytetarët e komunës, sot të trajtohen me dinjitetin më të lartë të mundshëm dhe ceremonia e varrimit në hapësirë publike.

Ka impakt të të gjithë ne, koncepti i diskutimit publik sot i këtij dokumenti është në këtë mënyrë, pas fjalës hapëse time do të ketë një fjalë përvendetëse edhe fjalë elaboruese të shkurtër, drejtori i Shërbimeve Publike zoti Çelë Lamaj. Pastaj të nderuar të pranishëm do të keni kohën tuaj me ngritje dore emër mbiemr që të procesverbalit ta përfshijë emrin mbiemrin dhe kontributin që do të jepni.

Ju ftojmë që të jeni totalisht të hapur, pa hezitim, të merrni fjalën dhe të jepni idetë e juaja për këtë dokument. Ky dokument nuk e mbyll diskutimin me qytetarët sot, për arsy se deri në datën 20 maj

2025 do të pranojmë edhe online sugjerime dhe ide përmes platformave dhe webfaqes së komunës. Po si finale dokumenti do të shkojë edhe në drejtim të Kuvendit të Komunës. Drejtori do të kujdeset që me kryetarin dhe kryesuesen të marrin pikë meritore në një prej mbledhjeve të ardhshme të Kuvendit.

Aty të gjithë kuvendare që përfaqësojnë edhe partitë të ndryshme politike do të kenë kohën e tyre dhe mundësinë e tyre që të japid ide, sugjerime, gjetje e çfarëdo tjetër dhe në fund fare dokumenti do të votohet dhe pastaj Drejtoria e Shërbimeve Publike e fiton të drejtën që të gjitha kërkesat që i ka dokumenti t'i zbatojë edhe teknikisht në teren me operatorët ose me subjektet me të cilat realizohet kjo politikë publike që janë varreza të reja të qytetit. dhe tashmë e dimë se qyteti është në kërkesë të përditshme në drejtim të komunës që sa më shpejt që është e mundur lokacioni i ri të jetë në funksion të kësaj situate për arsy se varrezat e vjetra tashmë janë të stërbushura dhe qytetarët kanë vështirësi për të gjetur hapësirë, për t'i varrosur më të dashurit e tyre edhe pse është moment pikëllimi.

**Celë Lamaj**, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, të nderuar pjesëmarrës, sot para jush ekziston një draft dokument rreth varrezave të reja të qytetit Prizreni që ka qenë kërkesë e kamotshme edhe qytetarëve edhe bashkësive fetare duke e ditur që bashkësia fetare islame kryesisht në lokacionin e vjetër është stërgarkuar.

Kjo iniciativë është marrë vite më parë, mirëpo asnjëherë nuk ka mundur të futet në funksion për shkak të procedurave tjera ku me ardhjen në qeveri të zotit Totaj është marrë shumë seriozisht ky lokacion dhe faktikisht po vjen dita ku do të funksionalizohet dhe pritet që gjatë këtij vitit duhet të fillohet veç me varrimet në lokacionin e ri. Sot nuk po i shoh bashkësitetë fetare këtu, me të cilët kemi pasur takim edhe me ta.

Domethënë, gjatë hartimit të kësaj rregullore, ku kisha mundur me e falënderuar në këtë rast kontributin e konsulencës edhe komisionit, i cili ka mbajtur takim me radhë dhe është marrë deri te një dokument i tillë, i cili në një seancë, që mendojmë në këtë seancë që do të marrë gjatë muajit maj në asamblenë komunale ta merre edhe miratimin dhe partneri jonë në këtë rast të fillojë me finalizimin e atij lokacioni rreth varrimit të qytetarëve.

Ne mendojmë si qeveri lokale se është një prej projekteve më të rëndësishme dhe premtimeve të zotit Totaj që varrezat të qytetit, më në fund, e kanë gjetur lokacionin e përshtatshëm dhe për disa vite me radhë mund të themi për 30-40 vjet është zgjedhur problemi i varrezave të qytetit të Prizrenit.

Prandaj kërkoj edhe nga ju të pranishëm këtu që të jepni komente tuaja rreth draft dokumentit që ta bëjmë këtë dokument sa më funksional që pastaj gjatë funksionalizimit mos hasin në ndonjë problem rreth këtij dokumenti. Kështu që jeni të hapur, ky dokument ëshët i publikuar edhe në webfaqen e komunës ka kohë sa e di unë edhe disa ditë, javës së ardhshme që mund të jepni komentet e juaja dhe ta plotësojnë pra këtë dokument dhe ta bëjnë sa më funksional.

Parcela do te ketë mbi 58 hektarë, do të jetë hapësirë për të gjitha komunitetet. Është hartuar një projekt të cilin e kemi është një projekt kryesor. Edhe ka me pas hapësira të mjaftueshme për të gjitha bashkësitetë fetare.

Nga kjo foto këtu i drejtohem i edhe bashkësive komunitetit të komuniteteve fetare disave u kemi pasur adresat edhe ja kemi dorëzuar si draft dokument dhe sa më shpejt që ata kanë mundësi të na ofrojnë nëse kanë vërejtje, sugjerime, komentet e tyre që ta plotësojnë këtë dokument.

Faleminderit. Faleminderit si drejtor.

**Ymër Berisha**, edhe njëherë komuna qytetarin e ka në fokus, kërkesën e tij dhe jeni duke e parë se Prizreni në tërë territorin e komunës është kthyer në kantier ndërtim kemi hyrë në Shatërvan që është guxim edhe teknik edhe politik për ta rregulluar dhe infrastrukturën e elektrifikimit ta bëjmë nën tokë. Kemi hapur rrugë të reja të cilat e kanë ndihmuar dhe po e ndihmojnë komunikacionin dhe zhvillimin e tij të lirë.

Tanimë kërkesa e bashkësive fetare, siç e thotë drejtori, edhe kërkesa e të gjithë qytetarëve për varreza të reja të qytetit dhe ndihemi krenar që brenda pak muajve do të fillojnë varrimet e reja, kështu që bashkë me qytetarin dhe kërkesat e tyre do të rrotullojnë gjatë kohës drejt sukseseve, sukseseve të reja. Jemi të hapur për mendimet e të gjithëve, atyre që mendojnë se mund të kontribuojnë në secilin fushë ose në secilin politikë publike të komunës e Prizrenit.

Tani ju ftoj me një ngritje dorë emër-mbiemër për shkak të procedurës së procesverbalit dhe ta komentojmë dokumentin që Drejtoria e Shërbimit Publike sot e ka në konsultim publik.

**Eroll Shabani** nuk kam me shtuar diçka specifike disa herë është një problem teknik me këto webfaqe edhe derisa e kemi marrë rregulloren, hala nuk kemi mbërrit me shqyrty detaje, por gjithsesi nëse e shohim të arsyeshme si EC ma Ndryshe deri më datën 20 do i paraqesim me siguri komentet apo sugjerimet.

Sa përket nevojës, drejtori e shprehu sepse me të vërtetë është një nevojë e madhe sepse shpesh edhe ne si EC e kemi ngritur si shqetësim edhe te ne poashtu qytetarët ndryshtë me paraqesin si shqetësim mungesën e hapësirës në varreza, kështu që besoj që del më e mira edhe të arrihet të finalizohet ky projekt mjaft i nevojshëm.

**Besim Kryeziu** jam përfaqësues i komunitetit protestant. Përshëndetje për këtë diskutim të hapur. Megjithatë, ne nuk kemi marrë një rregullore të tillë, nuk kemi informuar, kështu që e kam shqetësim kështu nuk e kam pasur, pra, rastësisht e pash në televizioni e Prizrenit për këtë njoftim edhe erdha. Nuk e di pse, por, besoj se do të kishte qenë e udhës që me e sjell dokumentin, ta kemi këtu dhe plus kësaj, jam anëtar në këshill, në KKSB, do të duhet të isha i njoftuar për këtë.

**Ymer Berisha**, Faleminderit, nëse unë e cek se i kemi pasur disa adresa, të cilat ja kemi dërguar, nuk kemi pasur adresën e juaj. Plus dokumenti është në web-faqen e komunës, që është publik, që e kemi mundur me e vendos aty, po nuk është vonë. Qysh sot mundem me thënë që edhe nëse duhet edhe një pjesë fizike të dokumentit t'ju ofroj, shkoni në drejtorinë e shërbimeve publike aty është Përparimi dhe ju siguron një material të tillë.

Dikush tjetër? Nëse nuk kemi, atëherë unë edhe njëherë në emër të kryetarit këtu do ju falënderoj se cilin veç e veç dhe të gjithë qytetarët e komunës tonë. Nuk do të jetë dokumenti i fundit as politika e fundit publike që del në konsultim me qytetarët e qytetit të Prizrenit.

Dëshirojmë që të jemi bashkë me qytetarët në rrugëtimet tona dhe në arritjet tona, madje edhe në takimet tjera që mund t'i kemi duke e përmirësuar njëri-tjetrin dhe duke komunikuar sa më afër që është e mundur. Komuna është e hapur, komuna është e qytetarëve, për qytetarët, kështu që shihemi në konsultime të tjera publike ose debate të tjera.

Faleminderit shumë edhe njëherë për pranimin tuaj.

#### **Konsultimi ka përfunduar në orën 11:35**

Në këtë vegëz: <https://www.facebook.com/share/v/16R9t2Yrx8/>, mund të gjeni video incizimin e konsultimit publik.

Procesmbajtës:

Laura Suka

Haziz Krasniqi

